

Sadik KRASNIQI

**Trashëgimia materiale-historike e kompleksit memorial
“AdemJashari” në Prekaz**

Përpjekjet e popullit shqiptar të Kosovës për çlirim kombëtar nuk pushuan asnjëherë gjatë historisë, që nga lashtësia e deri te lufta e UÇK-së 1998/99. Gjatë këtij rrugëtimi të gjatë dhe me plot sakrifica të mëdha dhanë kontribut të çmueshëm shumë familje dhe personalitete të shquara shqiptare, sidomos në prizmin luftarak. Ndër to më e veçuar në fund të shekullit XX është padyshim familja Jashari nga Prekazi i Skënderajt, e cila që nga vitet e ‘80-ta dha një kontribut të madh për çlirimin e vendit. Pikërisht kjo familje për shkak të aktiviteteve atdhetare që zhvilloi u bë cak i regjimit okupues serb.¹ Ndër protagonistët kryesorë që njiheshin në familjen Jashari për veprimtarinë e tyre patriotike ishin: Shaban Jashari-kryefamiljar, Rifat Jashari, Hamëz Jashari, komandanti legjendar Adem Jashari dhe disa pjesëtarë të tjerë të kësaj familjeje. Ngjarjet dramatike fillojnë të zhvillohen sidomos gjatë viteve 1990/91, pikërisht më datën 30 dhjetor të vitit 1991, kur kjo familje për herë të parë rrethohet nga forcat policore ushtarake serbe. Në mëngjesine ftohtë të atij vititrupat policore dhe makineria luftarake serbe kërkuan dorëzimin e komandantit Adem Jashari. Mirëpo, tre vëllezërit Jashari (Rifati, Hamza dhe Ademi) nuk iu binden barbarëve serbë për dorëzim dhe kështu ata iu kundërpërgjigjen me zjarr policisë duke e çarë rrethimin me grykën e pushkës, me ç’rasti lanë të plagosur disa policë serbë.

¹ Intervistë me Murat Jasharin, më 06.11.2014, Prekaz.

Familjes Jashari, përkatësisht tre vëllezërve Jashari, u erdhën në ndihmë fshatarët e kësaj ane.² Rrethimi i dytë i kësaj familjeje u bë në mëngjesin e 22 janarit të vitit 1998, kur një njësitë i specializuar serb rrethon dhe e sulmon këtë familje me armë të ndryshme si me minahedhës, mortaja dore dhe automatik. Këtij sulmi iu kundërpërgjigjen me zjarr Shaban Jashari me të birin Hamzën dhe me nipat Fitimin, Besimin dhe Kushtrimin. Forcat serbe nga vendi i ngjarjes largohen në mënyrë të turpshme. Në këto luftime nga familja Jashari u plagosën Selvetja dhe Ilirjana, që ishin në mbështetje të trimave që e mbronin shtëpinë.³ Dhe kulminacioni i rezistencës së kësaj familje në krye me komandantin legjendar Adem Jasharin, do të arrinte pikërisht me rrethimin e tretë, më 5 mars të vitit 1998. Gjatë gjithë natës Prekazi ishte rrethuar i tëri me artilerinë më të rëndë të forcave policore-ushtarake serbe, që për objektiv sikur edhe dy herëve të tjera ishte Kulla Qëndresë e Jasharajve, e cila për tri ditë rresht, më 5, 6 dhe 7 mars, u bëri ballë sulmeve të pareshtura të makinerisë serbe.

Familja Jashari në krye me legjendën Adem Jashari, kësaj radhe do të qëndrojnë për jetë a vdekje dhe ashtu ndodhi nga të gjithë (20 pjesëtarë të familjes së ngushtë të Shaban Jasharit), familjarët u vranë sa ishin në shtëpi, shpëtoi vetëm Besarta dhe Bashkimi. Ndërsa, jashtë shtëpisë që edhe i shpëtuan vrasjes, ishin: Rifati, Murati, Bekimi dhe Lulzimi që gjendeshin në mërgim, si dhe Iliriana, Shqipja, Marigona dhe Fazliu, të cilët një ditë më parë kishin shkuar te dajallarët në Akrashticë. Nga ky sulm u vranë edhe pjesëtarë tjerë të familjes së gjerë të Jasharajve si dhe disa luftëtarë, shqiptarë të tjerë, miq dhe

²*Po aty.*

³ Emin Halimi, Ajnishahe Shala, *Jasharët, Histori e një qëndrese*, Rilindja 2000, f.24.

fshatarë të Prekazit me rrethinë.⁴ Adem Jashari me familje para se të vriteshin i kishin dhënë besën njëri-tjetrit se të gjithë do të luftonin dhe do të vriteshin për çlirimin e vendit. Madje Adem Jashari para se të vritej pati deklaruar: “Nuk do të dorëzohem për së gjalli, vrastarët nuk do të kalojnë veçse mbi trupin tim të vdekur”. Akti i trimërisë dhe i sakrificës sublime të kryekomandantit legjendar Adem Jashari me familje është një shembull i rrallë në botë, që tregon se si duhet të vdiset për atdhe, liri dhe dinjitet. Lufta në Prekaz ishte një kushttrim i përgjithshëm për luftë të hapur frontale e cila më pas do të zhvillohej përgjatë dy viteve deri në çlirimin e vendit.⁵ Më datën 11 mars të vitit 1998, në vendin e quajtur Fusha e Pajtimit, u varrosen 59 dëshmorë, në mesin e tyre edhe katër të vrarë në rrethinën e Skënderajt. Pas përfundimit të luftës në Kosovë (1999), me iniciativën e Këshillit Komunal të Skënderajt, dhe të komandës së UÇK-së të Zonës Operative të Drenicës, merret vendim që të themelohet Fondacioni për Ngritjen e Kompleksit Përkujtimor “Adem Jashari” në Prekaz (FNKP). Ky fond u themelua më 5 maj të vitit 2000, i cili kishte për qëllim themelimin dhe financimin e kompleksit në fjalë. Drejtor i Fondacionit zgjidhet z. Shaban Hoxha, i cili përkujdesej për çdo gjë që lidhej me kompleksin, posaçërisht angazhohej për pagat e punëtorëve, mirëmbajtjen e objektit dhe nevojat e tjera që kishte ky muze.⁶ Është me rëndësi të potencohet fakti se ky fondacion ka bërë përgatitjen e projektit me titull: “Plani dhe programi urbanistik i kompleksit” dhe një seri aktivitete profesionale. Në mbarëvajtjen e punëve në kompleks janë kujdesur një varg ekspertësh të ndryshëm nga të gjitha

⁴Po aty, f.26.

⁵ Sadik Krasniqi, *Lufta për çlirimin e Kosovës (1997-1999)*, Prishtinë, 2009, f.103.

⁶ Intervistë me Shaban Hoxhën, më 18.01.2012, Prekaz.

segmentet e nevojshme, por një kontribut të veçantë kanë dhënë ekspertët muzeorë të Muzeut të Kosovës, sidomos rreth evidentimit, inventarizimit të ekspozateve të kompleksit, infrastruktura ligjore, konservimi dhe restaurimi i ekspozateve,⁷ etj.

Gjatë kësaj kohe kontribut të rëndësishëm me projekte ideore dhe sidomos në konservimin dhe restaurimin e ekspozateve ka dhënë Muzeu Historik Kombëtar i Tiranës, nëpërmjet drejtorit, z. Moikom Zeqo. MHK (Muzeu Historik Kombëtar) jepte ide dhe këshilla profesionale me qëllim të mbarëvajtjes së punëve profesionale në kompleks ndër to janë:propozimi për emërtimin e kompleksit, aprovimi i ligjit për kompleksin, riformulimi i një projekti ideor në dy gjuhët (shqip-anglisht) rreth kompleksit, kërkesat me shkrim për ndihmë kompleksit memorial drejtuar institucioneve dhe personaliteteve ndërkombëtare, ide rreth strukturës ekspozuese të ndarë në disa dhoma muze etj.⁸ Ide tjera alternative janë paraparë edhe për objektet statike, varrezat, reliefin natyror, vendosja e skulpturave të ndryshme, e deri te përqsja sipas kriterëve muzeologjike e relikteve muzeore.⁹ Kontribut të çmuar në këtë drejtim ka dhënë edhe Instituti Popullor i Etnologjisë, sidomos në konservimin e materialeve muzeore (të rrobave) të tekstilit. Nga viti 2005, projektet e nevojshme rreth kompleksit memorial “Adem Jashari” në Prekaz i ka financuar Qeveria e Kosovës.¹⁰Ngjarja e madhe historike e Jasharajve në Prekaz, ka lanë pas vetes një trashëgimi të fortë materiale e cila do t’i shërbejë

⁷ Intervistë me Mehmet Gjoshin, më 10.12.2011, Prishtinë.

⁸ Moikom Zeqo, “Projekt-ide për Memorialin e Lirisë në Prekaz”, *Studime muzeologjike*, nr.1, Tiranë, 2002, f.101-104.

⁹*Po aty.*

¹⁰ Intervistë me Shaban Hoxhën, më 18.01.2012, Prekaz.

gjithmonë njerëzimit. Këto fakte që preken me dorë, janë një tjetër dimension shumë interesant nëpërmes së cilës argumentohet (pasqyrohet) historia e Jasharajve. Trashëgimia materiale-historike e Jasharajve, sot, vlerësohet të jetë njëra nga thesaret (sitet) më të mëdha të historisë moderne në etnikumin shqiptar dhe ndërkombëtar.¹¹ Ajo ndahet në dy pjesë, në pjesën e parë hyjnë objektet statike të palëvizshme dhe në pjesën e dytë hyjnë objektet apo koleksionet e lëvizshme. Në kuadër të objekteve statike përfshihen, tri shtëpitë (ndërtesat) e Shaban Jasharit, të cilat janë: oda e burrave që ka shërbyer kryesisht si vendtakim për mysafirët, miqtë e familjes, shokët dhe bashkëluftëtarët etj. Objekti në fjalë deri në fillim të luftës shërbeu ekskluzivisht për organizime ilegale-ushtarake të UÇK-së. Gjatë luftimeve që u zhvilluan në rrethimin e parë, të dytë dhe të tretë, pjesëtarët e kësaj familjeje nga ky objekt rezistuan frontalisht, duke u përballur me armë të ndryshme me policinë dhe ushtrinë jugosllave. Si rezultat i luftimeve të ndërsjella (objekti) oda e burrave nga të shtënat me predha të kalibrave të ndryshëm u dëmtua në masë të madhe. Nga të katër anë e saj shihen qartë gjurmët e terrorit dhe dhunës që policia dhe ushtria serbe që i shkaktoi sidomos gjatë rrethimit dhe përballjes së fundit në mars të vitit 1998.

Në odën e burrave ranë duke rezistuar Shaban Jashari dhe dy nipërit e tij.¹² Objekti në fjalë më së shumti është dëmtuar nga pjesa ballore. Shtëpia e ndejës (objekti dytë i familjes) në të cilën familja e madhe Jashari kryesisht gjinia femërore, përfshirë këtu, gratë, vajzat

¹¹ Intervistë me Riza Sadikun, më 24.05.2013, Prishtinë.

¹² Raport punë, Hulumtime kërkimore në teren rreth realizimit të projektit me titull: *“Ndërtimi i databazës me të dhënat e Muzeve të Kosovës”*, Tetor 2012, Sektori i Historisë në Muzeun e Kosovës, Prishtinë.

dhe fëmijët e familjes, rrinin ushqeheshin dhe mbi katin e parë të objektit, ishin dhomat e gjumit. Në rrethana luftime (me datën 5, 6 dhe 7 mars 1998) shtëpia e ndejës u godit nga të gjitha anët me të gjitha llojet e armëve të lehta dhe sidomos me predhat e kalibrave me të rënd të artillerisë ushtarake serbe. Në këtë objekt gjatë luftimeve kishte pozicionet komandanti legjendar Adem Jashari së bashku me disa pjesëtarë të tjerë të familjes, që ishin pjesë e rezistencës si dhe pjesa më e madhe e familjes që strehoheshin në podrumet e shtëpisë. Si rezultat i luftimeve të vazhdueshme treditore, objekti në fjalë u dëmtua pothuajse tërësisht, në të gjitha anët e saj, por pjesa e prapme në veri u dëmtua më së shumti, pasi ishte goditur me një predhë shumë të madh të topave dhe minahedhësve të artillerisë ushtarake serbe, e cila ishte fatale edhe për pjesën më të madhe të kësaj familje, me ç'rast u vranë pjesa më e madhe e familjes. Në këtë ndërtesë, pas tri dite rezistencë, u vra edhe komandanti Adem Jashari në pjesën tek shkallët afër ballkonit. Në objektin e tretë të kësaj familje, ishte shtëpia apo objekti në të cilën kryesisht ruheshin mjete të ndryshme amvisërie, makina e vegla mekanike e bujqësore dhe gjësende tjera ushqimore. Gjatë rezistencës së Jasharajve në këtë ndërtesë i kishte vendosur pozicionet luftarake Hamëz Jashari me dy-tre pjesëtarë tjerë të familjes. Edhe në këtë objekt u rezistua heroikisht, deri sa një predhë e kalibrit të madh të artillerisë ushtarake serbe e goditi ndërtesën me ç'rast mu në gjoks u qëllua për vdekje edhe heroi i kombit Hamëz Jashari.¹³Pjesë e këtyre objekteve është edhe furra e bukës, viza-vijë me shtëpinë e ndejës, e cila është përdorë përpjekjen e bukës dhe ushqimeve tjera të familjes. Bunkeri i famshëm, në të cilin janë strehuar për shumë vite, Hamza dhe Adem Jashari, gjatë fazës së ilegalitetit. Bunkeri gjendet në një largësi

¹³*Po aty.*

prej rreth 600 metrash nga shtëpitë e banimit nëpjesën malore kodrinore të fshatit Prekaz i Ulët, prej nga i vrojtonin me kujdes lëvizjet e armikut.

Pra, tri objektet kryesore të familjes Jashari përgjatë tri ditë luftimesh, ishin cak i sulmeve të vazhdueshme të policisë dhe ushtrisë Jugosllave deri në rezistencën e fundit të familjes Jashari. Krahas këtyre objekteve të familjes së ngushtë të Shaban Jasharit, janë edhe dy objekte tjera të familjes së gjerë të lagjes Jashari, në të cilat u bë rezistencë dhe njëkohësisht vlerësohen si dëshmi autentike të luftës, të cilat pasqyrojnë dhunë dhe terror shtetëror të ushtruar nga forcat paramilitare dhe militare serbo-jugosllave ndaj Jasharajve. Në anën tjetër është rezistenca e çeliktë që nëpërmes këtyre ndërtesave u rezistua për jetë a vdekje për 3 ditë e net pandërprerë. Po ashtu, kemi edhe shtëpinë familjare (objekti) i Hamid e Salë Jasharit, e cila ka një distancë prej 500 metrash nga shtëpitë e Shaban Jasharit. Edhe kjo familje ishte pjesë integrale e organizimit të UÇK-së të cilët rezistuan pa ndërprerë deri në rënie. Në këtë objekt luftuan Hamid Jashari dhe bashkëshortja e tij Salë Jashari. Objekti gjatë luftimeve është goditur nga të gjitha anët duke u dëmtuar tërësisht nga artileria serbe. Ndërtesa në fjalë, është dëshmi reale në të cilën shihen qartë gjurmët e dhunës. Në brendësi të shtëpisë, duke rezistuar u vranë së bashku Hamid e Salë Jashari dhe dy mysafirë që ishin miq shtëpie dhe vinin nga fshati Tërstenik i komunës së Drenasit: Smajl Xhemajl Bazaj dhe Fatime Xhemajl Bazaj, vëlla e motër. Shtëpia e Ismajl Jasharit, e cila gjendet në pjesën e epërme të varrezave të fshatit Prekaz i Ulët, në një distancë prej 300 metrash largësi nga shtëpitë e Shaban Jasharit, ishte pjesë e objekteve të shkatërruara nga dhuna serbe në njërin anë dhe qëndresa e bërë nga Ismajl Jasharit në anën tjetër, i cili bie gjatë

luftimeve në shtëpinë e tij. Kompleksi memorial “Adem Jashari”, në tërësinë e saj posedon edhe hapësirat ku janë të vendosura varrezat e dëshmorëve, reliefi i hapësirës natyrore (parku i gjelbëruar), etj.¹⁴ Të gjitha këto objekte sot, janë trashëgimia statike materiale e historisë së Jasharajve, në të cilat shihet qartë arkitektura e ndërtimit, struktura socio-ekonomike dhe dimensionin historik. Në prizmin arkitektonik, objektet paraqesin stilin dhe tipet e ndërtimit, në aspektin socio-ekonomik paraqitet niveli i lartë ekonomik dhe social që dispononte familja Jashari dhe në aspektin historik paraqet vlerat më sublimë që e lartësojnë këtë familje si dëshminë më autentike (unikale) të historisë së Jasharajve, rreth kauzës kombëtare shqiptare për çlirimin e vendit.¹⁵ Në grupin e dytë, hyjnë thesaret e trashëgimisë muzeore lëvizëse, përkatësisht koleksionet e kompleksit memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

Ato janë të karakterit të përgjithshëm dhe ndahen në disa karaktere, siç janë: koleksioni i ekspozateve të amvisërisë, veglave bujqësore, të punës, etnologjike dhe ushtarake. Që të gjitha e kanë një emërues të përbashkët që është vetë familja Jashari, rreth së cilës sillen të gjitha. Ekspozatat janë origjinale dhe shumica prej tyre janë të vendosura në vendin adekuat, pikërisht aty ku ka luajtur funksionin e vet para se të ndodhte ngjarja. Karakteristikat kryesore të këtij koleksioni që e veçojnë këtë familje, janë: përmes ekspozateve të veglave të punës tregohet përkushtimi, dashuria dhe serioziteti për të punuar, nëpërmes ekspozateve të amvisërisë paraqitet mënyra e të

¹⁴ Raport pune, Hulumtime kërkimore në teren rreth realizimit të projektit ekspozicional-muzeor me titull: “*Qëndresa heroike e Jasharajve për liri*”, Nëntor 2014, Sektori i Historisë së Muzeut e Kosovës, Prishtinë.

¹⁵ *Po aty*.

jetuarit, sekuenca nga mënyra e të ushqyerit, përgatitjes etj. Përmes koleksionit etnologjik prezantohet tradita, kultura dhe standardi i jetesës i kësaj familjeje në konotacion kohor kur ajo ka jetuar, përmes koleksionit ushtarak, përkatësisht, gjurmëve dhe dëshmime të luftës pasqyrohet rezistenca dhe sakrifica e saj, e cila dha mesazhe të qarta se si duhet të luftohet dhe të vdiset për lirinë e popullit dhe atdheut.¹⁶ Koleksionet e përgjithshme muzeore të kompleksit memorial “Adem Jashari” në Prekaz janë: koleksionet me motive nga etnologjia, përfshirë këtu materialet e tekstilit, rrobat dhe mobilieritë ndër më karakteristike janë veshjet me karakter kombëtar për femra dhe për meshkuj, plisi i bardhë i Shaban Jasharit, këpucë për fëmijë, këmisha, xhemperë dhe jelekë të femrave, punime dore (artizanale) për femra, palltoja e Shaban Jashari, vitrina, dollapë dhe shtretër për fjetje, djepi për rritjen e fëmijëve, magjja e bukës, e cila nuk lidhej vetëm me amvisërinë, por lidhej edhe menderin e shtëpisë. Nën këtë magje të bukës ishte fshehur Besarta shtatëvjeçare e cila i kishte shpëtuar terrorit serbetj. Koleksioni i veglave të punës, bujqësore dhe të tjera, në mesin e tyre më karakteristike janë: traktori i cili është i goditur me plumba dhe copë predhash të arsenalit ushtarak të forcave serbe, sharrë druri dhe metalike, çekan, lopata dhe makina të ndryshme metalike. Koleksionet e veglave të amvisërisë, ato më karakteristike janë: lavatriçja, frigoriferi, sofa e bukës, furra e gatimit, pjata të ndryshme, si: lugë, gota etj. Koleksionet e relikteve ushtarake më karakteristike janë: gëzhojat e kalibrave të ndryshëm të armëve të forcave serbe, me të cilat kanë bërë dhunë ndaj kësaj familje, gëzhojat janë të kalibrave

¹⁶ Raport pune, me rastin e themelimit të “Muzeut të Jasharajve” në Prekaz (në objektin e piramidës), Shkurt 2015, Sektori i Historisë në Muzeun e Kosovës, Prishtinë.

të ndryshëm, të minahedhësve, topave, kundërajrorëve, mitralozit, pushkës automatike e deri te ato më të vogla të revoleve.¹⁷Në mesin e këtyre gëzhjove, përveç atyre të forcave serbe, janë edhe gëzhjotat e armëve të lehta automatike të familjes Jashari, të cilat i ka përdorur gjatë luftimeve kundër forcave serbe. Gëzhjotat e armëve që i ka përdorur komandanti Adem Jashari, Hamza, mixha Shaban dhe anëtarët e tjerë të familjes janë: kalibrat e gëzhjove të mitralozave, automatikëve, pushkëve e deri te revolet. Në mesin e tyre gjendet edhe çiftja dhe arma artizanale si dhe bishti i çiftelisë të heroit të kombit Hamëz Jashari. Ndërsa, eksponatet që lidhen më komandantin Adem Jashari, sidomos ato luftarake (armët), nuk ekzistojnë, pasi janë të asgjësuar nga forcat serbe pas rënies së tij. Eksponatet e vetme që lidhen me komandantin legjendar Adem Jashari janë vetëm automatiku i tipit kallashnikov qëkomandanti e mori në Shqipëri gjatë ushtrimeve ushtarake dhe mitralozi i lehtë që ruhet nga familja si dhe dy motoçikleta të cilat i ka përdorur në shumë raste për udhëtime të shpejta prej një vendi në tjetrin, kryesisht për nevoja ushtarake-atdhetare. Koleksionet e përgjithshme të kompleksit memorial “Adem Jashari” në Prekaz janë numerikisht mbi 1000 sosh. Vlen të potencohet fakti se shumë thesare muzeore të këtij Muzeu janë shkatërruar gjatë luftës dhe një pjesë e madhe prej tyre janë marrë nga vizita të ndryshme nga dëshira e madhe për të pasur një shenjë të familjes Jashari. Këtë kompleks deri në mars të vitit 2018 e kanë vizituar mbi 10 milionë vizitorënga të gjitha trojet shqiptare. Përveç vizitorëve të rëndomtë kompleksin e kanë vizituar edhe figurat dhe personalitetet më të larta kombëtare nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia, si dhe personalitete

¹⁷ Të dhëna janë marrë nga koleksionet e përgjithshme muzeore të Kompleksit Memorial “Adem Jashari”,Prekaz.

të larta ndërkombëtare nga Evropa dhe bota, në mesin e tyre edhe komandanti i NATO-së Vesli Klark, Bernard Kushner, senatorë amerikanë, gjeneralë të ndryshëm etj. Lufta e fundit në Kosovë (1998/99), krahas shkatërrimeve dhe vrasjeve të mëdha që shkaktoi ajo, në anën tjetër krijoi edhe një histori të lavdishme me UÇK-në, për të cilën do të krijohen edhe shumë komplekse, muze, shtëpi e dhoma përkujtimore, në mënyrë që gjeneratat e reja dhe bota e civilizuar të njihet më për së afërmi dhe të komunikojnë me dëshmitë konkrete të ngjarjeve që kanë ndodhur në vendin tonë.¹⁸

Gjendja ekzistuese e objekteve të mëdha statike dhe e atyre të vogla të lëvizshme është në përgjithësi jo e mirë, janë të pakonzervuara; përjashtim bëjnë vetëm materialet muzeore të tekstilit (rrobat) të cilat janë në gjendje më të mirë, meqë një numër i madh i tyre janë konzervuar nga ekspertë profesionalë në Shqipëri. Me fjalë tjera, mund të thuhet se i gjithë materiali (thesari) muzeor në aspektin e konzervimit dhe restaurimit lë shumë për të dëshiruar.¹⁹Për sa i përket dokumentacionit të materialeve muzeore në kompleks, ato janë të inventarizuara sipas mënyrës klasike të evidentimit, ekziston libri amë në të cilën janë regjistruar të gjitha eksponatet me përmbajtje të ndryshme nga hekuri, druri, tekstili etj. Kompleksi aktualisht ka 3 punëtorë profesionalë, 2 prej tyre janë ciceronë dhe një shitës, pjesa tjetër e punëtorëve janë kryesisht teknikë të cilët kujdesen për sigurinë dhe ambientin e pastër. Kompleksi Memorial “Adem Jashari” prej vitit 2014 është inkorporuar institucionalisht në kuadër të Agjencisë për

¹⁸Po aty.

¹⁹Po aty.

Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës. Institucioni në fjalë menaxhohet nga Qeveria e Kosovës.²⁰

Përfundime dhe rekomandime

Rënia e Jasharajve preku ndërgjegjen e tërë kombit shqiptar dhe të gjithë opinionit botëror liridashës. Me këtë rast u mobilizua pjesa më e madhe e popullit shqiptar në Kosovë dhe jashtë saj si dhe me intervenimin edhe të Aleancës Ushtarake Veri-Atlantike “NATO”, kjo luftë përfundoi me lirinë e vendit. Prandaj, bazuar në të gjitha karakteristikat që u thanë më lart, vijmë në përfundimet se familja Jashari në krye me komandantin legjendar Adem Jashari padyshim janë thesaret më të çmuara të lirisë së Kosovës dhe të mbarë kombit shqiptar.

²⁰*Po aty.*